



**KOLEGJI UNIVERSITAR REALD**

---

**KOLEGJI UNIVERSITAR REALD**

**FAKULTETI I EKONOMISË**

**DEPARTAMENTI FINANCË**

**RREGULLORJA E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I  
SHKENCAVE NË “FINANCË DHE TREGJET FINANCIARE”**



## KOLEGJI UNIVERSITAR REALD

---

### KREU 1

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### Objekti i Rregullores

Rregullorja e programit të studimit **Master i Shkencave në “Financë dhe tregjet financiare”** përcakton parimet e funksionimit të këtij programi, në “Kolegjin Universitar “ Reald”.

#### Neni 2

#### Baza Ligjore

Rregullorja e programit të studimeve **Master i Shkencave në “Financë dhe tregjet financiare”** mbështetet në nenin 21, pikat 1,3,4 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për çeljen e programeve të studimit në Master i Shkencave në Financë dhe Tregjet Financiare”.

#### Neni 3

Të drejtën e kontrollit akademik mbi këtë strukturë akademike e ka Përgjegjësi i Departamentit, Dekani i Fakultetit, Zv.Rektori akademik dhe Rektori i Institucionit.

#### Neni 4

Të drejtën e kontrollit administrativ dhe financiar mbi këtë strukturë akademike e ushtron Bordi Administrativ dhe Rektori.



## KOLEGJI UNIVERSITAR REALD

---

### Neni 5

Financimi i programit të studimit Msc Financë dhe Tregje Financiare realizohet nga tarifa e shkollimit të studentëve, nga burime financiare brenda Institucionit ose nga burime jashtë tij, bashkëpunuese në këtë program studimi.

### Neni 6

Kohëzgjatja e programit të studimit Msc Financë dhe Tregje Financiare është dy vite akademik, në përfundim të të cilit studenti fiton 120 kredite akademike.

### Neni 7

Të gjitha lëndët e parashikuara në planin mësimor shlyhen me provim në semestrin përkatës.

### Neni 8

Praktika profesionale do të realizohet pranë qendrave të prodhimit, bizneseve dhe ndermarrjeve të ndryshme.

## KREU 2

### PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

#### Neni 9

##### Objektivat e Programit

Programi i Studimit Master i Shkencave në Financë dhe Tregjet Financiare përfaqëson vijimin e studimeve nga niveli Bachelor në nivelin pasuniversitar.

Ky program studimi ka për objektiv:

1-Të pajisë të diplomuarit me njohuri të thella teorike, si edhe me aftësim për kërkimin shkencor në sferën ekonomike, në fushën Financë dhe Tregjet Financiare ;



## **KOLEGJI UNIVERSITAR REALD**

---

2- Të ndihmojë individët dhe të orientojë organizatat në punësimin e tyre, me qëllim rritjen e efektivitetit të tyre manaxherial përmes fushës së financës- duke u siguruar studentëve një bazë të fortë me parimet dhe praktikën e financës duke u siguruar atyre mjetet e nevojshme analitike dhe aftësi të reja për formimin e një baze të fortë në vendimarrjen financiare.

### **Neni 10**

#### **Frekuentimi**

Frekuentimi i aktiviteteve formuese të programit të studimit Msc Financë dhe Tregje Financiare është i detyrueshëm në masën 80% për seancat brenda auditorit (leksione, seminare) dhe në masën 100% për praktikën profesionale të parashikuar në planin mësimor të këtij programi studimi.

---

## **KREU 3**

### **PROCEDURA E PRANIMIT TË STUDENTËVE**

#### **Neni 11**

Regjistrimet në programin e studimit Msc Financë dhe Tregje Financiare bëhen vetëm mbi bazën e një Diplome Bachelor.

#### **Neni 12**

##### **Kush mund ta zgjedhë këtë program?**

Flukset e pranimit të kandidatëve për fushën e studimit Master në “Financë dhe tregjet financiare” do të jenë të shumta.

Ky master u krijon mundësi më në mënyrë të vecantë ekonomistëve të cilët do të përfitonin studime të thelluara në fushën e gjerë të financës dhe të tregjeve financiare me qëllim kryesor



## KOLEGJI UNIVERSITAR REALD

punësimin si punonjës të : institucioneve financiare (publike e private ), të departamenteve financiare e ekonomike të Bashkive, drejtues korporatash apo menaxher kryesor; gjithashtu ky master është i dobishëm për individë që përballen me financën në rolet e tyre aktuale, dhe që duan të avancojnë në karrierën e tyre apo të ndërrojnë fushën e tyre me financën duke u bazuar te njohuritë e tyre financiare si :

1. Studentë që kanë një diplomë të nivelit të parë në Financë, Marketing, Kontabilitet, Biznes, Turizëm, etj.
2. Investues, tregtarë dhe bankierë
3. Punonjës të analizave të tregjeve kapitale dhe manaxhimit të riskut
4. Punonjës të korporatave financiare, bashkimeve të kapitalit
5. Punonjës të organizatave të shërbimeve si ato të konsulencave financiare dhe korporatave financiare të përbashkëta
6. Ky master është formuluar për studentë me kombësi të ndryshme, background-e të ndryshme kulturore që mund të sjellin në këtë program eksperiencë të ndryshme, motivim dhe sfida të reja.
7. Është program i përshtatshëm për të gjithë ata që kanë një interes të madh në karrierën e përgjithshme financiare, ose për ata që planifikojnë të ndryshojnë karrierën e tyre në financë.

Programi është praktik dhe i aplikueshëm, dhe synon të pasurojë eksperiencën e studentëve . Nuk është i përshtatshëm për njerëzit pa prioritet financiar, por është një zgjedhje e shkëlqyer për të gjithë ata që duan të ndërrojnë specialitet dhe të hyjnë në financë apo të zgjerojnë njohuritë e tyre financiare.

Mbi të gjitha, kandidatët duhet të tregojnë që ata kanë përkushtim, motivim dhe potencial për të përfutur prej tyre, cc'është më e rëndësishmja: të kontribuojnë në këtë program.

Njohuritë profesionale të fituara gjatë zhvillimit të studimeve mund të përdoren në profesione si konsulent financiar, ekonomistë, kontabël i miratuar, specialistë bankash, specialistë finance për sektorin publik dhe privat, specialistë dhe tregtar burse, analistë investimesh, etj. të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave reale të tregut të punës.



## **KOLEGJI UNIVERSITAR REALD**

---

### **Neni 13**

Për programet e Master i Shkencave në Financë dhe Tregjet Financiare do të shqyrtohen aplikantët në bazë të mesatares së ciklit të parë të studimeve.

### **Neni 14**

Të gjitha aplikimet për programet pasuniversitare do të bëhen nëpërmjet kërkesës së aplikantit. Kandidatet duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së institucionit një kërkesë me shkrim, Diplomë ose fotokopje të saj të njehsuar me origjinalin e fituar në ciklin e parë të studimeve, Diplomën e shkollës së mesme dhe certifikatën e notave ose fotokopje të secilës të njehsuar me origjinalin, Formulari i aplikimit sipas udhëzimit të MAS, Fotokopje e dokumentit të identifikimit, Dy fotografi.

Dokumentacioni do të shqyrtohet nga Bordi i Administrimit të Kolegji Universitar “Reald” dhe do të përcillet tek Dekani i Fakultetit përkatës, nga ku me pas del vendimi për pranim ose jo.

## **KREU 4**

### **DIPLOMIMI I STUDENTËVE**

#### **Neni 15**

Për të marrë diplomën Master i Shkencave në Financë dhe Tregjet Financiare kandidatët duhet të mbrojnë një Teze Diplome.

#### **Neni 16**

Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma: “Msc Financë dhe Tregje Financiare” sipas modelit që figuron në pikën 8 të këtij dokumentacioni.



## KOLEGJI UNIVERSITAR REALD

---

### Neni 17

#### Teza e diplomes

Teza duhet te jete dicka originale shkencore.

i) Tema duhet te shkruhet sipas formatit te percaktuar nga Kolegji Universitar "Reald" dhe te aprovohet nga Komisioni i Tezes dhe nga Udheheqesi i Tezes.

ii) Tema duhet te mbrohet edhe me goje perpara Komisionit te Tezes.

#### Udheheqesi shkencor dhe Komisioni

- Komisioni i Tezes perbehet nga katër vete duke perfshire edhe Udheheqesin.
- Udheheqesi per Masterin Shkencor duhet te jete me titullin jo me pak se "Dr".
- Udheheqesi per Masterin Shkencor duhet te jete nje pedagog i stafit pedagogjik te specializuar ne fushen e kerkimit shkencor qe ata kane zgjedhur.
- Dy anetare te Komisionit duhet te jene nga fusha e studimit.

Nje anetar duhet te jete nga nje department tjeter qe ka program te Masterit Shkencor

### Neni 18

Diploma Msc Financë dhe Tregje Financiare (MSC) firmosen nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Kolegji Universitar "Reald".

### Neni 19

Diploma Msc Financë dhe Tregje Financiare (MSc), përpara se të lëshohen nga Kolegji Universitar "Reald", duhet të regjistrohen në regjistrin shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.



**KOLEGJI UNIVERSITAR REALD**

**KREU 4  
DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 20**

**Miratimi dhe zbatimi i Rregullores**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Senatin Akademik të Kolegjit Universitar "Reald" dhe zbatimi i saj sigurohet nga rektori.

**REKTORI**

**Prof. Dr. SABIT BROKAJ**

**Në mungesë dhe porosi**

**Zv/Rektori**

**Prof.As.Dr.Petrit K...**

